

**VENDIM**  
**Nr. 161, datë 17.3.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 226, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 226, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, masa 3% ndryshohet dhe bëhet 5%;
2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. “Financimin e kostos së menaxhimit të projekteve, në kuadër të programit të rindërtimit që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit. Kjo kosto është në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**